

Vendim nr. 277 datë 15.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 15.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 17 (M) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **MARIGLEN PËRGJINI**, përfaqësuar nga avokat Ferid Muçaj, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 966, datë 26.12.2018 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2024-732 (106), datë 18.04.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 31, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 71, pika 1, 71/a, 71/b dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 10.01.2013, rreth orës 02:00, salla operative e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Lezhë (*DPQ, Lezhë*) ka marrë njoftim se në lokalin e shtetasit L.T., i ndodhur në vendin e quajtur “Kryqëzimi i Shën Kollit”, Lezhë, ka ndodhur plagosja me armë zjarri e shtetasit M.Sh., i cili pak çaste më vonë ka ndërruar jetë. Për këtë ngjarje Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka regjistruar një procedim penal, në kuadër të të cilit ka ngritur akuzë edhe ndaj shtetasit Mariglen Përgjini (*kërkuesi*) për kryerjen e veprave penale “Vrasja me dashje” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake”, dy herë, të parashikuara nga nenet 76 dhe 278, paragrafi 2, të Kodit Penal (*KP*). Në përfundim të hetimeve paraprake çështja penale është dërguar për gjykim.

2. Në gjykimin e çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 373, datë 15.09.2014, ndër të tjera, ka vendosur deklarinim fajtor të kërkuesit për veprat penale “Vrasja nga pakujdesia” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake”, dy herë, duke e dënuar atë përfundimisht, në bashkim të dënimeve, me 7 vjet burgim. Pas ankimit të këtij vendimi nga prokurori dhe të pandehurit, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 114, datë 09.03.2015, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe kthimin e akteve për rigjykim pranë asaj gjykate.

3. Në rigjykimin e çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 262, datë 09.09.2016, ndër të tjera, ka vendosur deklarinim të pafajshëm të kërkuesit për veprën penale “Vrasja me dashje” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake”, vetëm për sa i përket mbajtjes së armës së zjarrit që ka shkaktuar vdekjen e shtetasit M.Sh., ndërsa e ka deklaruar fajtor atë për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake”, duke e dënuar me 3 vjet burgim dhe urdhëruar shuarjen e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” të caktuar ndaj tij për shkak se kohëzgjatja e paraburgimit (fillimisht nën masën “Arresti në burg” dhe më pas “Arresti në shtëpi”) ishte më e madhe se masa e dënimit të caktuar për të. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim prokuroria dhe të pandehurit, ndërsa kërkuesi vetëm për sa i përket masës së dënimit. Ankim kanë paraqitur edhe familjarët e viktimës.

4. Gjykata e Apelit Shkodër, pas përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, me vendimin nr. 966, datë 26.12.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rigjykimit të shkallës së parë dhe deklarinim fajtor të kërkuesit për veprat penale: “Vrasja me dashje” dhe dënimin e tij me 15 vjet burgim; “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake” dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim; “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake” dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim, ndërsa në bashkim të dënimeve i ka caktuar një dënim të vetëm me 18 vjet burgim.

5. Për rekursin e paraqitur nga prokuroria (vetëm për të gjykuarin E.N.), kërkuesi dhe të gjykuarit e tjerë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në seancë në dhomën e këshillimit mbi

bazë të dokumenteve, me vendimin nr. 00-2024-732 (106), datë 18.04.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit.

6. Në datën 16.08.2024 (sipas shërbimit postar) kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 12.09.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

7.1. *Së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur*, pasi Gjykata e Lartë, në kushtet e ekzistencës së dy vendimeve diametralisht të kundërta, duhet ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve.

7.2. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi organi i akuzës, qoftë në gjykimin e çështjes në shkallë të parë, ashtu edhe në apel, nuk ka paraqitur asnjë provë që të vërtetojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm akuzën e ngritur ndaj kërkuesit. Gjykata e apelit ka gabuar në çmuarjen e provave, ndërsa nuk ka marrë parasysh dëshmitë në gjykimin e çështjes të disa dëshmitarëve, por i ka dhënë vlerë të paracaktuar deklarimeve të bëra nga ata në fazën e hetimeve paraprake, të cilat nuk përbëjnë provë sipas nenit 362 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Kjo mënyrë të vepruari bie në kundërshtim me ligjin dhe praktikën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Gjykata e apelit nuk është ndalur në vlerësimin e provave thelbësore të kërkuesit, të cilat provonin pafajësinë e tij, duke dënuar një person të pafajshëm për veprën penale të vrasjes.

7.3. *Parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve*, pasi gjykata e apelit ka analizuar vetëm provat që ishin në favor të akuzës, duke mos analizuar provat në favor të kërkuesit, shkelje kjo që ka cenuar edhe parimin e prezumimit të pafajësisë.

7.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i gjykatës së apelit në drejtim të çmuarjes së provave është i padrejtë, jo objektiv, i njëanshëm dhe haptazi në kundërshtim me ligjin material dhe procedural. Arsyetimi i asaj gjykate është krejtësisht joprofesional, absurd dhe alogjik. Edhe vendimi i Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar, i përgjithshëm dhe kontradiktor, ndërsa konkluzionet e saj janë të padrejta dhe të papranueshme në raport me provat dhe ligjin. Ajo

gjykatë nuk u ka kthyer përgjigje pretendimeve në rekursin e kërkuarit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë dhe atij të barazisë së armëve.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kolegji vëren se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual dhe ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, rezulton se kërkuari i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, Kolegji konstaton se ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

11. Kërkuari legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 18.04.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 16.08.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

12. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuari ka pretenduar cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar dhe mbrojtur, të parimit të prezumimit të pafajësisë, të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, si dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

13. Për sa i takon pretendimit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, kërkuksi ka parashtruar se në kushtet kur ekzistojnë dy vendime diametralisht të kundërta, Gjykata e Lartë duhet ta kalonte çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Kolegji vëren se pretendimi i kërkuksit, në thelb, lidhet me formën e gjykimit të çështjes së tij nga Gjykata e Lartë. Kjo e fundit e ka shqyrtuar çështjen në seancë në dhomën e këshillimit mbi bazë dokumentesh dhe, në përfundim, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit. Sipas ligjit procedural penal, nenit 436/a, pika 1, të KPP-së, shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç kur ai kolegji vlerëson se ekziston ndonjë prej rasteve të përcaktuara në nenin 437, pika 1, të KPP-së. Në këto kushte, shqyrtimi edhe i rekursit të kërkuksit në rastin konkret nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit mbi bazë dokumentesh është bërë sipas formës së gjykimit të përcaktuar nga ligji, ndërsa kolegji penal i saj nuk ka vlerësuar ekzistencën e ndonjë prej rasteve të përcaktuara nga ligji për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt, nuk nënkupton vetëm atë për t'u dëgjuar personalisht para gjykatës, por ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra mbi komentet dhe shpjegimet e dhëna me shkrim nga palët (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret rezulton se Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim jo vetëm rekursin e kërkuksit, por edhe parashtrimet me shkrim të avokatit të tij të depozituara në datën 11.04.2024, përpara shqyrtimit të çështjes. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ky pretendim i kërkuksit nuk mund të merret në shqyrtim.

14. Për sa u takon pretendimeve për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, si dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, nisur nga argumentet e parashtruara, të cilat, në thelb, lidhen me vendimmarrjen dhe arsytimin e gjykatave të zakonshme, ato do të trajtohen së bashku, ndërsa *prima facie* janë me natyrë kushtetuese.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe atij të kontradiktoritetit e barazisë së armëve

15. Kërkuksi ka pretenduar se organi i akuzës, qoftë në gjykimin e çështjes në shkallë të parë, ashtu edhe në apel, nuk ka paraqitur asnjë provë që të vërtetojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm akuzën e ngritur ndaj tij, ndërkohë që gjykata e apelit ka gabuar në çmuarjen e provave ndërsa nuk ka marrë parasysh dëshmitë në gjykimin e çështjes të disa dëshmitarëve, por i ka dhënë vlerë të paracaktuar deklarimeve të bëra nga ata në fazën e hetimeve paraprake,

të cilat nuk përbëjnë provë sipas nenit 362 të KPP-së. Kjo mënyrë të vepruari, sipas kërkuesit, bie në kundërshtim me ligjin dhe praktikën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Po ashtu, vijon kërkuesi, gjykata e apelit ka analizuar vetëm provat që ishin në favor të akuzës, duke mos analizuar provat në favorin e tij, të cilat provonin pafajësinë e tij, duke dënua kështu një person të pafajshëm për veprën penale të vrasjes. Po sipas tij, vendimi i gjykatës së apelit në drejtim të çmuarjes së provave është i padrejtë, jo objektiv, i njëanshëm dhe haptazi në kundërshtim me ligjin material dhe procedural, duke qenë arsytimi i asaj gjykate krejtësisht joprofesional, absurd dhe alogjik. Edhe vendimi i Gjykatës së Lartë, sipas kërkuesit, është i paarsyetuar, i përgjithshëm dhe kontradiktor, ndërsa konkluzionet e saj janë të padrejta dhe të papranueshme në raport me provat dhe ligjin, përveçse ajo gjykatë nuk i ka kthyer përgjigje pretendimeve në rekursin e tij për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë dhe atij të barazisë së armëve.

16. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës (*shih vendimet nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se parimi i prezumimit të pafajësisë nënkupton se gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri e ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuzat (*shih vendimet nr. 13, datë 24.04.2018; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë së të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimet nr. 13, datë 24.04.2018; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket parimit të barazisë së armëve, Gjykata është shprehur se ai nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes tyre. Për respektimin e këtij parimi gjykatës së zakonshme i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore

që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin konkret, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, në rigjykimin e çështjes të zhvilluar me procedurën e zakonshme, ka vendosur deklarinin fajtor të kërkuesit vetëm për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake” (një herë), ndërsa e ka deklaruar atë të pafajshëm për veprat penale “Vrasja me dashje” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake”, vetëm për sa i përket mbajtjes së armës së zjarrit që ka shkaktuar vdekjen e shtetasit M.Sh. Në lidhje me deklarinin e pafajshëm të kërkuesit, ajo gjykatë ka arritur në përfundimin se nuk provohet që kërkuesi të ketë kryer veprën penale “Vrasja me dashje” ndaj shtetasit M.Sh., ndërsa referuar provave të administruara gjatë gjykimit dhe të vlerësuara në unit, autor i saj është i pandehuri E.N. Për këtë përfundim ajo gjykatë është bazuar në deklarinimet në gjykim të disa dëshmitarëve, në deklarinimet në gjykim dhe në hetimet paraprake të të pandehurve, në deklarinimet në hetimet paraprake të disa dëshmitarëve të tjerë, si dhe në rezultatet e përgjimeve të komunikimeve telefonike. Nga ana tjetër, ajo gjykatë ka vlerësuar se thëniet e disa dëshmitarëve gjatë hetimeve paraprake në lidhje me autorësinë e kërkuesit jo vetëm që nuk konfirmohen me prova të tjera të administruara gjatë gjykimit, por ato kanë edhe kundërshti midis tyre, çka i bën të pabesueshme.

19. Mbi ankimin e prokurorisë dhe të të pandehurve (kërkuesi vetëm për sa i përket masës së dënimit), sikundër edhe të familjarëve të viktimës, Gjykata e Apelit Shkodër, pas përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë duke e deklaruar kërkuesin fajtor për të tria akuzat, pra për veprat penale “Vrasja me dashje” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake” (dy herë), ndërsa e ka dënuar atë përfundimisht me 18 vjet burgim. Sipas gjykatës së apelit, vendimi i gjykatës së shkallës së parë është rrjedhojë e interpretimit dhe çmuarjes së gabuar të provave dhe, për pasojë, në zbatim të gabuar të ligjit material. Sipas asaj, gjykata e shkallës së parë, në kushtet kur në gjykim janë administruar prova të kundërta për fakte të rëndësishme për procesin, duhet t'i vlerësonte ato duke u bazuar në kritere të tilla, si: koha e marrjes së tyre në raport me ngjarjen, duke mbajtur parasysh se për provat e mëvonshme ekziston mundësia e ndikimit dhe manipulimit; qenia e tyre direkte apo indirekte; qenia e tyre e anshme apo e paanshme dhe e pandikuar nga interesa të ngushtë personale.

20. Referuar këtyre kritereve, gjykata e apelit në vijim ka arritur në përfundimin se provat e paraqitura nga organi i akuzës dhe ato të marra kryesisht nga ajo, të analizuar dhe të çmuara në tërësi dhe harmoni me njëra-tjetrën, provojnë tej çdo dyshimi të arsyeshëm fajësinë e kërkuesit. Për këtë ajo është bazuar në deklarinimet e bëra në hetimet paraprake nga dy dëshmitarë okularë, pyetja e të cilëve në gjykim ka qenë e pamundur (për shkak të vdekjes dhe

të largimit jashtë vendit) dhe në rezultatet e përgjimit ambiental të tyre, si dhe në deklaratimet e bëra në hetimet paraprake të disa dëshmitarëve të tjerë okularë menjëherë pas ngjarjes, duke mos marrë parasysh deklaratimet e tyre në gjykim për mungesën e dijenisë për autorin e vrasjes, si deklaratime që nuk përputheshin me prova të tjera, të pabesueshme dhe që mund të ishin bërë nën ndikim ose presion. Ajo po ashtu është bazuar edhe në të dhënat e aktit të ekspertimit mjekoligjor të viktimës të krahasuara me deklaratimet e dëshmitarëve për pozicionin në tavolinë të saj dhe të të pandehurve, si dhe me të dhënat e procesverbalit të këqyrjes së vendit për gjurmët e lëna nga predha. Gjithashtu, ajo ka vlerësuar edhe faktin se nga të gjithë të pranishmit në ngjarje, vetëm kërkuesi është larguar menjëherë pas saj. Për sa u përket përgjimeve të komunikimeve telefonike, gjykata e apelit ka vlerësuar se ato përbëjnë mjet për kërkimin e provës, çka do të thotë se mund t'i shërbejnë gjykatës për të përcaktuar vërtetësinë ose jo të provave të tjera apo, në rast se janë lidhur me indicje të tjera, të provojnë faktin përkatës. Në fakt, sipas saj, ato përgjime nuk janë të lidhura me asnjë provë tjetër thelbësore direkte, me përjashtim të provave të krijuara më vonë nga shtetas të cilët nuk kanë qenë prezent në ngjarje, nga dëshmitarë të njëanshëm në lidhje me kërkuesin apo nga biseda mes familjarëve të të pandehurve pa interes në drejtim të autorit të veprës penale.

21. Çështja është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë mbi rekursin e prokurorisë (vetëm për sa i përket të gjykuarit E.N.), të kërkuesit dhe të të gjykuarve të tjerë, ku në përfundim ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit. Fillimisht, në vendimin e saj Gjykata e Lartë ka evidentuar se pretendimet për vlerësim të gabuar të fakteve dhe provave nuk mund të merren në shqyrtim prej saj, pasi kjo del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të saj. Në vijim, ajo gjykatë ka evidentuar se qëndrimet e kundërta të gjykatave të faktit në lidhje me fajësinë e kërkuesit kanë ardhur si rezultat i vlerësimit të ndryshëm të provave, ku gjykata e shkallës së parë u ka dhënë vlerë provave dhe dëshmime të dhëna në gjykim, duke çmuar jo të besueshme dhe me vlerë provuese deklaratimet e dhëna në fazën paragjyqësore/gjatë hetimit paraprak, ndërsa, në të kundërt, gjykata e apelit ka analizuar provat në tërësinë e tyre, duke zbatuar institutin e kundërshtimit të dëshmisë në interpretim të nenit 362 të KPP-së.

22. Lidhur me këtë moment, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se në interpretim të nenit 362, por edhe të nenit 370 të KPP-së, si dhe referuar jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*çështja Unterpertinger kundër Austrisë; çështja Kostovski kundër Hollandës; çështja Berhani kundër Shqipërisë; çështja Caka kundër Shqipërisë*), ligji procedural penal në parim parashikon se të gjitha provat duhet të jepen në prani të pandehurit, por, përjashtimisht, lejohet edhe përdorimi i deklaratave të dhëna në fazën paragjyqësore, për sa kohë respektohen të drejtat e mbrojtjes, të cilat si rregull kërkojnë që i pandehuri të ketë mundësi të pyesë një dëshmitar në një fazë të caktuar të procesit gjyqësor, të ketë mundësitë dhe hapësirat e

nevojshme për parashtruar argumentet e tij për të kundërshtuar dëshminë e një dëshmitari, si dhe për t'u ballafaquar me të, elemente këto të rëndësishme të një procesi të drejtë ligjor. Në rastin konkret, sipas saj, të gjykuarit, përfshirë dhe kërkuesin, jo vetëm janë mbrojtur nga avokatë të zgjedhur/të besuar dhe u është garantuar mbrojtja efektive (në rastin e gjykimit në apel), por kanë pasur të gjithë hapësirën dhe mundësitë të pyesin dëshmitarët apo të paraqesin të tillë.

23. Në lidhje me provat dhe procesin e të provuarit, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se në interpretim të nenit 152 të KPP-së dhe referuar edhe jurisprudencës së GJEDNJ-së (*çështja Van Mechelen dhe të tjerë kundër Vendeve të Ulëta*), mënyra e trajtimit të provave është një aspekt i rëndësishëm i procesit të drejtë, vlerësimi i të cilit konsiston në lidhje me: faktin nëse të pandehurit dhe mbrojtësit të tij u janë krijuar të gjitha mundësitë dhe lehtësitë e nevojshme për t'u njohur me provat dhe për t'i kundërshtuar ato gjatë procesit penal, në lidhje me vërtetësinë dhe bazueshmërinë e përmbajtjes së kësaj prove, por edhe të çdo prove tjetër të verifikuar në këtë proces penal; (ii) "cilësinë e provës", që nënkupton se prova i nënshtrohet një verifikimi thelbësor në lidhje me mënyrën e marrjes së saj, pra nëse ajo është marrë në situata të tilla që ndikojnë në besueshmërinë dhe vlefshmërinë e saj. Për çmuarjen e provave në rastin konkret, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se të gjykuarve, përfshirë dhe kërkuesin, nuk u janë cenuar të drejtat procedurale apo e drejta e mbrojtjes, as në gjykim, as në fazën e hetimeve paraprake. Aktet e marra gjatë hetimit paraprak u janë njoftuar mbrojtësve përkatës gjatë ose në përfundim të hetimeve, ndërsa ata kanë pasur të gjitha mundësitë për kundërshtimin e tyre në gjykatë. Për sa u përket pretendimeve të ngritura nga mbrojtja e të gjykuarve, në veçanti për kërkuesin, ato kanë marrë përgjigje gjatë gjykimit në apel, ndërsa ajo gjykatë ka respektuar të drejtën e të pandehurve për të marrë dhe për të verifikuar çdo provë në ngarkim të tyre, sikundër edhe për të paraqitur prova në favorin e vetë, duke respektuar parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetin, si dhe duke u krijuar të pandehurve të gjitha mundësitë për realizimin e një mbrojtjeje sa më efektive.

24. Sipas Gjykatës së Lartë, vendimi i gjykatës së apelit është arsyetuar në përputhje me kërkesat e ligjit procedural penal dhe me standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar, duke u dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara në apel nga prokuroria dhe të gjykuarit. Po sipas saj, gjykata e apelit, në përputhje me nenin 152 të KPP-së, ka vlerësuar dhe analizuar provat në tërësi dhe në lidhje me njëra-tjetrën, duke mos i dhënë vlerë të paracaktuar apo mbivlerësuar asnjë prej provave që janë lejuar dhe marrë në këtë gjykim. Fajësia e të gjykuarve, vijon ajo, nuk bazohet në një provë të vetme, ndërsa gjykata e apelit ka analizuar dhe evidentuar provat në tërësi, duke argumentuar vendimmarrjen e saj konform ligjit. Në këtë drejtim, Gjykata e Lartë ka vlerësuar të drejta qëndrimet e gjykatës së apelit në lidhje me deklaratimet e

dy dëshmitarëve okularë në vendin e ngjarjes, thëniet e të cilëve gjatë hetimit paraparak janë vlerësuar në raport me provat e tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre (referuar akteve të këqyrjes së vendit të ngjarjes, këqyrjes së kufomës së viktimës, transkriptimeve të bisedave ambientale të përgjuara apo edhe dëshmive/deklarimeve të personave të tjerë që janë pyetur në kuadër të këtij procesi penal). Për sa u përket dëshmive të dhëna gjatë gjyqimit nga dëshmitarët e pranishëm në ngjarje, të cilat janë pjesërisht në kundërshtim me ato çfarë ata kanë deklaruar në momentet e para kur janë pyetur nga organi procedues, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykata e apelit i ka analizuar ato në raport me provat dhe indicjet e tjera të marra gjatë hetimit, por dhe në gjykim, duke arsyetuar se ku qëndrojnë përputhjet dhe kundërshtitë mes tyre, si dhe duke vlerësuar besueshmërinë e tyre në raport me tërësinë e provave. Po sipas saj, gjykata e apelit ka analizuar edhe provat e kundërta të parashtruara nga kërkuesi, rrethanat e pretenduara prej tij, duke analizuar këto veprime të tij në raport me provat e tjera e duke i dhënë përgjigje të argumentuar alibisë së ngritur nga ai. Provat e marra në hetim dhe gjykim janë bërë pjesë e debatit gjyqësor dhe gjykata e apelit, ndryshe nga ajo e shkallës së parë, ka arritur në konkluzionin e drejtë se fajësia e të gjithë të gjykuarve për veprat penale për të cilat janë akuzuar rezulton e provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

25. Në analizë të vendimeve të kundërshtuara, Kolegji konstaton se gjykata e apelit e ka deklaruar fajtor kërkuesin, duke shqyrtuar e vlerësuar provat në tërësi dhe në harmoni me njëra-tjetrën. Nuk rezulton që ajo të ketë krijuar bindjen apriori për fajësinë e tij. Kërkuesit i është garantuar e drejta për të marrë dhe për të verifikuar çdo provë në ngarkim të tij, sikundër edhe për të paraqitur prova në favorin e vetë. Në vijim, ligjshmëria e vendimmarrjeve të gjykatës së apelit është vlerësuar nga Gjykata e Lartë edhe në raport me pretendimet e ngritura në rekursin e kërkuesit, i cili ka marrë përgjigje për to. Nga përmbajtja e vendimeve të kundërshtuara nuk rezulton që ato të kenë mungesë arsyetimi, të jenë të paqarta apo alogjike dhe që gjykatat e zakonshme të mos kenë respektuar standardet e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për sa u përket pretendimeve të kërkuesit në lidhje me vlerësimin e provave dhe zbatimin e ligjit, Kolegji sjell në vëmendje se në jurisprudencën e Gjykatës në mënyrë konstante është pohuar se mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre, nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi e gjykatës së zakonshme provohet se ka cenuar të drejta kushtetuese të individit, në kuptimin që procesi në tërësinë e tij rezulton haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar (*shih vendimet nr. 34, datë 12.06.2023; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret nuk evidentohet një mënyrë e atillë veprimi nga gjykatat e zakonshme, e cila të ketë cenuar të drejta

kushtetuese të kërkesit, në kuptimin që procesi në tërësinë e tij të jetë haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar.

26. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimi për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe atij të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve është haptazi i pabazuar.

27. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.